

KRYEVEPRAT E LETËRSISË BASHKËKOHORE  
ÇMIMET NOBEL

BOTIME TË TJERA NGA KOLONA LETËRSIA  
BASHKËKOHORE

- Knut Hamsun** (fitues i Çmimit Nobel) - Misteret  
**Ivo Andriç** (fitues i Çmimit Nobel) - Kronikat e Travnikut  
**D.H.Lawrence** - Gra të dashuruara  
**Marguerite Yourcenar** - Vepra në të zezë  
**Irène Némirovsky** - Jezabel  
**Irène Némirovsky** - Zjarret e vjeshtës  
**Jean Giono** - Kalorësi në çati  
**Giorgio Bassani** - Kopshti i Finci-Kontinëve  
**Giorgio Bassani** - Gjyslyket e arta  
**John Williams** - Stoneri  
**J.G.Ballard** - Perandoria e Diellit  
**Mark Haddon** - Rasti i çuditshëm i vrasjes së qenit në mesnatë  
**John Wyndham** - Dita e Trifidëve  
**Christa Wolf** - Kasandra  
**Bernardo Atxaga** - Shtëpia e tetë  
**Paul Auster** - Trilogjia e Nju Jorkut  
**Paul Auster** - Libri i iluzioneve  
**Anna Gavalda** - Të ishim bashkë... vetëm kaq  
**Anna Gavalda** - Unë e doja  
**Eduardo Mendoza** - Asnjë lajm nga Gurbi  
**Peter Høeg** - Ndjesia e Smillës për dëborën  
**Petros Markaris** - Lajmet e natës  
**Tess Gerritsen** - Të luash me zjarrin

Günter Grass

Me hapin e gaforres

Roman

Në shqip nga **Afrim Koci**

Botimet *IDK*

Titulli i origjinalit në gjermanisht:Günter Grass - Im Krebsgang  
- Eine Novelle - Dtv - 2015

Copyright © Steidl Verlag, Göttingen 2002

Copyright notice: © of the translation: S. Fischer Foundation by  
order of TRADUKI

Copyright © për botimin shqip nga Botimet IDK

traduki<sup>T</sup>

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Zyra e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran “Pro Helvetia”, “KulturKontakt Austria” (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), Instituti “Goethe”, Agjencia Sllovene e Librit “JAK”, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni “S. Fischer.

ISBN 978-9928-136-52-7

Art grafik: Valbona Lila

Botimet IDK

Rr. Myslym Shyri, Pall. 47, Ap 4, K. 1

Tiranë, Albania

Tel: +355 4 4507853

Web site: [www.idk-al.org](http://www.idk-al.org)

E-mail: [idk@idk-al.org](mailto:idk@idk-al.org)

“Përse ke pritur deri tani?” - tha dikush që nuk jam unë. Epo, sepse nëna papushim më... Sepse doja të bërtisja njëloj siç bëra asokohe kur britma rrinte pezull përmbi ujë, por nuk mundja... Sepse historia e vërtetë si zor më shumë se tre rreshta... Sepse vetëm tani...

Edhe sot e kësaj dite fjalët s’më vijnë lehtë. Por dikush që nuk i honeps dot bishtnimet, më kujton profesionin që kam. Sepse që kur qesh spurdhjak i vogël, më thotë ai, unë isha i zoti të xhongloja me fjalët kur nisa atë stazhin si reporter në një nga gazetat e Shpringerit\*, ku pa shkuar shumë ia mora dorën mirë asaj pune, derisa pastaj kalova te “taz”\* (*Frankfurter Tageszeitung*), ku Shpringeri ishte shënjestra e preferuar, më pas, u pajtova përkohësisht si mercenar për një sërë agjenci lajmesh, dhe më në fund, një copë herë të mirë punova si gazetar *freelance*, duke hedhur nëpër artikuj gjithë çfarë dilte taze e ngrohtë nga furra: çdo ditë diçka të re. Të rejtat e ditës.

Mund të jetë edhe kështu, them unë. Sepse fundja, kjo është e vetmja gjë që unë di të bëj. Po nëse sot do më duhet vërtet të rrëfej sot historinë e jetës sime, fajin për gjithçka që më ka shkuar ters do t’ia vija mbytyjes së një anijeje. Sepse kur kjo ndodhi, nëna ishte në muajin e nëntë të shtatzënisë,

sepse, në fund të fundit, është krejt një rastësi dhe që unë vetë jam gjallë...

Dhe ja ku jam prapë në shërbim të dikujt, por së paku tani për tani mund ta lë veten jashtë nga kjo histori, e cila, ç'është e vërteta, fillon shumë kohë para meje, më se njëqind vjet më parë, në qytetin Shverin, kryeqendra e dukatit të Meklenburgut, që shtrihet midis shtatë liqenesh dhe nëpër kartolina mburret me lagjen *Schelfstadt*, si dhe me një kështjellë me katër kulla, e cila që, të themi atë që është, i ka shpëtuar paq dëmtimeve të luftës.

Fillimisht as që besoja se një qytezë krahinore e lënë prej kohësh në harresë nga historia, do të mund të joshte njeri, hiq natyrisht, turistët, mirëpo ja që pastaj, papritur e pakujtuar, kjo vendnisje e historisë sime u bë befas aktuale në internet. Një person anonim zuri të hidhte aty të dhëna biografike, me data, emrat e rrugëve dhe dëftesat e shkollës, një thesar i vërtetë për një rrëmues të së kaluarës, siç isha unë.

Bleva edhe unë një *Mac* me modem, me të dalë këto gjëra në treg. Në profesionin tim e kam të domosdoshme ta gjurmoj informacionin kudo që ky mund të endet nëpër botë. Së pari, doemos, mu desh të mësoja më së miri si ta përdorja kompjuterin. Shumë shpejt termat *browser* dhe *hyperlink* nuk ishin më arabisht për mua. Me një klikim të miut arrija të nxirra të dhëna që mund të më hynin në punë, apo dhe që mund të përfundonin në koshin e plehrave. Shpejt, nga qejfi apo nga mërzia, fillova të hidhem nga një *chatroom* në tjetrin, duke iu përgjigjur edhe *junk mail*-it më të marrë, madje i hodha një sy ashtu shpejt e shpejt dhe nja dy faqeve porno, derisa duke vozitur ashtu kuturu ndesha

në ca *site* ku nostalgjikë të së djeshmes, por po ashtu edhe të rinj neonazistë të pagëzuar taze, derdhnin helmin e tyre në faqe të mbushura plot urrejtje. Dhe befas, - duke përdorur si fjalëkalim emrin e një anijeje, - arrita të hyja në adresën e duhur: *www.blutzeuge.de*. Me shkronja gotike, një farë “Vëllazërie e Shverinit”, e mbushur plot e dokrra, kryesisht diçka për një martir nga e shkuara. Qenë gjëra që të bënin më tepër për të qeshur se sa për të vjellë.

Ndërkohë, tashmë sidoqoftë, e kam të qartë se për ç’martir bëhet fjalë, e përse supozohej ta kishte derdhur ai gjakun. Por ajo për të cilën unë ende nuk jam i sigurt është se cila do të ishte mënyra më e mirë për t’iu qasur kësaj pune: a mos duhet që, ashtu siç më kanë mësuar, të shpalos me radhë njërin, e pastaj tjetrin jetëshkrim, apo, mos është më mirë t’i qasem kohës skiç, pak a shumë ashtu siç bëjnë gaforret, që ngjajnë sikur po ecin bythambrapsht e anash, por që në të vërtetë bëjnë me shpejtësi përpara? Sidoqoftë, një gjë është e sigurt: natyra apo më saktë, deti Baltik, tashmë ka më shumë se gjysmë shekulli që ka thënë Po dhe Amin, për gjithë sa do të thuhet këtu.

Së pari e ka radhën dikush guri i varrit të të cilit është shkatërruar. Pasi mbaroi shkollën e mesme, - dëftesë pjekurie - ai vajti të bënte stazhin në një bankë, të cilin e përfundoi ashtu pa rënë shumë në sy. Për këtë fazë të jetës së tij nuk gjeta asgjë *online*. Vetëm faqen që i kushtohej posaçërisht atij, Vilhem Gustlofit, i lindur në vitin 1895 në Shverin, ku ai himnizohej si “një martir”. Por as aty s’thuhej asnjë fjalë për problemet që ai kishte pasur me laringun, apo për sëmundjen kronike të mushkërive që s’e kish lenë

ta tregonte trimërinë gjatë Luftës së Parë Botërore. Po ndërkohë që Hans Kastorpit, një djalosh prej një familje të mirë hanseatike, iu desh që me urdhër të krijuesit të tij të largohej prej Malit Magjik\* dhe në faqen 994 të romanit me të njëjtin emër, s'i mbetej më veçse o të dilte vullnetar e të vente të gjente vdekjen diku në fushat e Flandrës, o të shpëtonte lëkurën duke ia mbathur në tokën e askujt, në vitin 1917 Shoqëria e sigurimeve e Shverinit u kujdes ta çonte nëpunësin e saj të vyer në Zvicër që të kuronte lëngatën e tij. Në ajrin e shëndetshëm të Davosit, ai e mori aq mirë veten sa që tashmë vdekja mund ta shtinte në dorë vetëm në ndonjë formë tjetër: hë për hë ai as që e çonte më nëpër mend të kthehej në Shverin, në klimën e Gjermanisë së Poshtme.

Vilhelm Gustlofi gjeti punë si ndihmës në një observator. Sapo ky institut studimor u shndërrua në një fondacion helvetik, ai u ngrit në postin e sekretarit të observatorit, që i linte megjithatë kohë të fitonte edhe ca të ardhura shtesë duke punuar si përfaqësues i një shoqërie që shiste sigurime familjare. Dhe kështu, kjo punë e dytë i dha rastin të njihej me gjithë kantonet e Zvicrës. Njëkohësisht edhe e shoqja, Hedviga, s'kishte ndenjtur duarkryq: ajo punonte si sekretare në zyrën e një avokati me emrin Mozes Zilberot, pa qenë e detyruar të flijonte bindjet e saj *volkisch*\*.

Deri tani faktet na japin tablonë e një çifti të lidhur me një martesë të shëndetshme borgjeze, por që, siç do ta shohim më vonë, mënyra e tyre e jetesës vetëm sa shtirej sikur i përshtatej konceptit zviceran të një pune me përfitim. Në fillim fshehurazi, më vonë gjithnjë e më hapur, - dhe për një kohë të gjatë pa u penguar aspak nga



punëdhënësi, - sekretari i observatorit e vuri në punë me mjaft sukses aftësinë e tij të lindur organizative: ai hyri në partinë naziste dhe deri aty nga fillimi i tridhjetë e gjashtës arriti të rekrutonte rreth pesëmijë anëtarë të rinj ndërmjet gjermanëve dhe austriakëve që jetonin në Zvicër, duke ngritur me ta celula vendore në mbarë vendin, ku anëtarët e rinj i betoheshin për besnikëri dikujt që Providenca e kishte menduar si *Fyrer*.

Sidoqoftë, grupenlajter të Zvicrës atë e emëroi Gregor Shtraseri dora vetë, sekretari organizativ i partisë. Shtraseri bënte pjesë në krahun e majtë të partisë, dhe dy vjet pasi më 1932 kishte dhënë dorëheqjen nga çdo funksion partiak për të protestuar për lidhjet e afërta të Fyrerit me industrialistët e mëdhenj, vajti u përfshi në puçin e Rëmit, dhe u likuidua nga vetë njerëzit e tij. I vëllai, Oto, mundi të shpëtojë duke u larguar nga Gjermania. Për pasojë Gustlofit iu desh të kërkojë një shëmbëlltë të tjetër për ta ndjekur si idhull.

Kur pas një pyetjeje të bërë në këshillin kantonial të Graubundenit, një oficer i policisë për të huajt e paskësh pyetur Gustlofin se si e kuptonte ai detyrën e *Landesgruppenleiter*-it të Partisë nacional-socialiste gjermane në Konfederatën Helvetike, me ç'thuhet ai na qenkësh përgjigjur. "Më tepër se çdo gjë në botë unë dua gruan dhe nënën time. Por, po të më urdhërojë Fyreri im t'i vras, unë do t'i bindem"

Në internet ky citim kundërshtohet, si një gënjeshtëri, si edhe të tjera të këtilla, sajesa të shkrimtarit çifut Emil Ludvig në atë paçavuren e tij, thuhej në *chatroom*-in e hapur nga vëllazëria e Shverinit. Përkundrazi, pretendohet se ndikimi i Gregor Shtraserit mbi "martirin" kishte mbetur i gjallë.

Gustlofi gjithnjë e kishte theksuar se në botëkuptimin e tij elementi socialist kishte përparësi ndaj atij nacionalist. Shpejt midis çatuesëve shpërtheu lufta midis krahut të djathtë dhe atij të majtë. Një natë virtuale e thikave të gjata\* kërkoi viktimat e veta.

Mirëpo pastaj të gjithë të interesuarve iu bë thirrje të kujtonin një datë që duhej të provonte se gjithçka s'kish qenë veç një dëshmi e vullnetit të Providencës. Ajo që unë qesh përpjekur ta shpjegoja si thjeshtë një rastësi, e ngriti funksionarin partiak Gustlof, duke e bërë atë pjesë të një plani qiellor: në 30 janar të vitit 1945, pikërisht në pesëdhjetë vjetorin e lindjes së martirit, anija e pagëzuar me emrin e tij u mbyt, duke paralajmëruar kështu fundin e Rahjut, pikërisht dymbëdhjetë vjet pas marrjes së pushtetit prej nazistëve.

Ajo është aty, si e gdhendur me daltë në granit. Ajo datë e mallkuar me të cilën filloi gjithçka, që më pas u rrit vrastare, mbërriti kulmin e vet, e pastaj shkoi drejt fundit. Edhe unë, falë nënës, zë fill pikërisht në ditën e asaj fatkeqësie. Sidoqoftë, ajo vetë jeton sipas një kalendari tjetër, duke mos pranuar të njoh plotfuqinë e rastësisë, apo ndonjë lloj shpjegimi tjetër të ngjashëm.

“Por jo, jo! - thërret ajo, që unë nuk e thërras kurrë me pronorin “nëna ime”, por thjeshtë “Nëna”, - Çfarëdo emri që t'i kishin venë asaj anijeje, ajo prapëseprapë do t'ishte mbytur. Ajo që unë dua të di është, çfarë kishte në mendje ai rusi kur dha urdhër të çojnë ato të treja drejt e tek ne...?”

Kështu llafos ajo, a thua se qysh atëherë të mos ketë rrjedhur aq shumë kohë. Fjalë tërkuzë, fjali të tjerra litar.

Ajo i thotë patates *bullwen*, kajmakut *glumse*, dhe kur gatuan merluc të zierë në mustardë e quan atë *pomuchel*. Prindërit e nënës, August dhe Erna Pokrifke, ishin nga një zonë e quajtur Koshnajderaj\* ndaj dhe quheshin koshnajderas. Por ajo vetë ishte rritur në Langfur. Nuk ishte nga Dancigu, por nga ajo lagjja tepër e shtrirë e rrethinave, që vinte duke u zgjeruar pareshtur në drejtim të fushës, njëra rrugë e së cilës quhej Elzenshtrase dhe që për vazhën me emrin Ursula, të cilën e thërrisnin shkurt Tula, qe e gjithë bota, sepse kur ajo, si shprehej nëna, rrëfen “për qëmoti” del se shkonte shpesh për tu larë në bregun e afërt të Detit Baltik, apo për të rrëshqitur me slitë në pyjet në jug të lagjes, por më së shumti ajo i çon dëgjuesit në oborrin e shtëpisë që kishin marrë me qira në rrugën Elzenshtarse 19, dhe prej andej, duke kaluar para Harrasit, qenit të stanit të lidhur me zinxhir, në një zdrukthëtari plot zhurmë të shkaktuar nga një sharrë cirkulare, e një tjetër me shirit, një frezë, një trapano dhe një makinë e madhe zdruguese. “Që kur isha camërdhoke e vogël më vinin të përzieja poçen e tutkallit...” Ndaj edhe kudo të ndodhej vajza me emrin Tula, kudo të ishte, në këmbë, shtrirë, duke ecur, duke vrapuar, apo galiç në ndonjë qoshe, asaj, siç tregojnë, i vinte gjithmonë era tutkall.

Nuk është pra, për tu habitur që kur, fill pas lufte, ne erdhën dhe u ngulëm në Shverin, nëna u fut për të mësuar zanatin e zdrukthëtarisë në Shelfshtadt. Si e “shpërngulur”, siç quheshin në Lindje, e caktuan menjëherë praktikante te një mjeshtër, baraka karakatinë e të cilit me katër zdruktha të mëdhenj dhe me poçen e tutkallit gjithmonë duke gurgulluar, njihej si vendase denbabaden. Prej aty dy hapa

ishin deri në Lemsstrase, ku nëna dhe unë kishim mbi kokë një strehë me çati prej letre katrama. Por sidoqoftë, edhe sikur pas katastrofës të mos kishim dalë në breg në Kolberg, por përkundrazi torpedinieri “Lowe” të na kishte zbritur në Travermynde apo në Kil, me një fjalë në Perëndim, duke qenë një “refugjate e lindjes”, siç i quanin edhe atje, me siguri nënën praktikante zdrukthëtarie do ta kishin futur. Unë e konsideroj këtë një rastësi, kurse ajo që ditën e parë e kishte konsideruar vendin ku qemë të detyruar të qëndronim si të paracaktuar.

“Se ja, po të mos kishte pasur ai rusi, që ishte kumandari i nëndetëses ditëlindjen atëkohë? Ti e di shumë mirë...”

Jo, për këtë unë s’kam aq shumë informacion sa ç’kam për Vilhelm Gustlofin, të nxjerrë prej internetit. Kisha mundur të gjeja në internet vetëm vitin kur ai kishte lindur, si edhe disa pak fakte dhe hamendësime të tjera nga ato që ne gazetarët i quajmë material plotësues.

Aleksandër Marinesko u lind në vitin 1913 dhe pikërisht në qytetin skelë të Odesës, në bregun e Detit të Zi, që dikur duhet të ketë qenë një mrekulli, siç del nga filmi bardhezi “Karrocata Potjomkin”. E ëma e tij ishte ukrainase, i ati rumun dhe në letërnjoftim kishte nënshkruar “Marinesku”, përpara se të dënohej me vdekje si pjesëmarrës në kryengritje, por që në minutën e fundit kishte mundur të ikte.

I biri, Aleksandri, u rrit në qytetin-skelë dhe duke qenë se në Odesë rusët, ukrainasit dhe rumunët, grekët dhe bullgarët, turqit dhe armenët, ciganët dhe çifutët jetonin rrasur e ngjeshur së bashku, ai fliste një mishmash gjuhësh,

por që me sa duket kuptohej mirë në rrethin e bandës së tij të rinisë. Sado që u mundua më vonë të fliste rusisht, ai nuk e arriti kurrë plotësisht ta pastronte supën e ukrainishtes së tij të përzier me thjerrëza në jidish, nga sharjet rumune të trashëguara nga i ati. Më vonë kur u pajtua si muço në një anije tregtare shokët e qeshnin për çorbën e tij; por në rrjedhë të viteve, shumëkujt nuk i vinte më për të qeshur, sado komike që mund t'i dukeshin më vonë urdhrat e komandantit të nëndetëses.

Po le të kthehemi shumë vite pas: Aleksandri shtatëvjeçar do të ketë parë nga bulevardi i bregdetit se si po ia mbathnin me nxitim që nga Odesa mbeturinat e ushtrisë “së bardhë” dhe çfarë kishte shpëtuar nga armata intervencioniste britanike dhe franceze. Siç kishte qenë dëshmitar, pak më vonë, edhe i hyrjes së të “kuqve”. Atëherë kishin filluar spastrimet. Pastaj kishte përfunduar edhe lufta civile. Dhe disa vite më vonë, kur anijet e huaja mund të ankoroheshin përsëri në molo, me ç’thuhet, djaloshi ishte kredhur më guxim, por më vonë edhe me shkathtësi, në grykëderdhjen e lumit, për të kapur monedhat që hidhnin udhëtarët e veshur mirë.

Treshja nuk është ende e plotë. Njëri ende mungon. Ishte veprimi i tij që vuri në lëvizje një valë të fuqishme, e cila do të rezultonte e pandalshme. Sepse dashje pa dashje, kishte qenë ai që e kishte shndërruar atë që kishte ardhur nga Shverini në një martir të Lëvizjes, kurse djalin nga Odesa në hero të flotës “Flamuri i kuq” e Baltikut, duke ia siguruar kështu me shumë gjasë përjetësisht vetes një vend në bankon e të akuzuarve. Fajësime të tilla dhe të ngjashme

i gjeja në atë faqe interneti ku, gjithnjë e më tepër kureshtar, hyja duke kërkuar përherë me të njëjtë frazë: “Një çifut ka shtënë...”.

Siç e di edhe unë ndërkaq, një vepër polemike e botuar në vitin 1936 nga shtëpia botuese Eher Verlag e Mynihut, e shkruar nga anëtari i partisë dhe oratori i Rajhut, Wolfgang Diverge, është edhe më e drejtpërdrejtë në këtë drejtim. Ç’është e vërteta, Vëllazëria e Shverinit, sipas logjikës së patundur të marrëzisë, shpallte me të madhe madje më tepër nga ç’mëtonte të dinte dhe vetë Dirvegeja: “Të mos kishte qenë çifuti, katastrofa detare më e madhe e të gjitha kohëve nuk do të kishte ndodhur kurrë në kanal in e pastruar nga minat, në Shtëlpermynden e Epërme. Çifuti ishte ai që shtiu... çifuti është fajtor...”.

Sidoqoftë, disa fakte mund të qëmtoje nga llogaritjet pjesërisht gjermanisht dhe pjesërisht anglisht në atë *chatroom*. Njëri prej çatuesve dinte se pak kohë pas fillimit të luftës Divergeja kishte qenë drejtor i Radios së Rajhut në Dancig, kurse një tjetër kishte dijeni për veprimtarinë e tij gjatë periudhës së pasluftës: në bashkëpunim me nazistë të tjerë të lartë, si për shembull me Ashenbah, që më vonë do të bëhej edhe deputeti i FDP në Bundestag, Divergeja thuhej se kishte arritur të depërtonte te Partia Liberale e Nordrajn-Vestfalisë. Përveç kësaj, plotësonte një i tretë, gjatë viteve shtatëdhjetë ish eksperti nazist i propagandës kishte drejtuar pa shumë zhurmë një institut i cili merrej me pastrim fondesh për llogari të FDP, dhe pikërisht në Nojvid të Rinit. Së fundi *chatroom*-i i mbushur dingas gëlonte nga pyetjet për vrasësin e Davosit, së cilave përgjigjet e sakta iu vinin pikat mbi i.

Katër vjeç më i madh se Marinesko dhe katërmbëdhjetë vjeç më i ri se Gustlofi, David Frankfurteri u lind në vitin 1909 në qytetin Daruvar të Sllavonisë Perëndimore, si djalë i një rabini. Në shtëpi ata flisnin jidish dhe gjermanisht, në shkollë Davidi mësoi të flasë dhe të shkruajë serbisht, por provoi në kurriz edhe urrejtjen e përditshme ndaj çifutëve. Me ç’duket: përpjekjet e tij për t’u përballuar me këtë situatë duhet të kenë qenë të pasuksesshme, e para se ndërtimi i tij trupor nuk ia lejonte një mbrojtje të fortë, e dyta se ai e përbuzte vetë nocionin se jeta duhej pranuar ashtu siç qe.

David Frankfurteri kishte vetëm një gjë të përbashkët me Vilhelm Gustlofin: njëlloj si i pari që fillimisht kishte gjetur belanë me sëmundjen e tij të mushkërive, edhe ai kishte vuajtur që në fëmijëri nga osteomyelitis kronik i palcës kurrizore. Por në qoftë se Gustlofi mundi ta kuronte shpejt lëngatën e tij dhe pastaj të bëhej sërish një anëtar i devotshëm partie, Davidit të sëmurë nuk kishte doktor që t’i ndihmonte; më kot iu nënshtrua pesë operacioneve: rast i pashpresë.

Mbase për shkak të sëmundjes ai iu fut edhe studimeve për mjekësi; dhe sipas këshillës familjare, në Gjermani, ku kishte studiuar edhe i ati, edhe i ati i të atit. Thuhet se duke qenë vazhdimisht i pamundur dhe për pasojë me aftësi të kufizuar përqendrimi, ai u rrëzua qoftë në provimin e pranimit, qoftë edhe në provime të tjera. Por anëtari i partisë Diverg pohonte në internet, në kundërshtim me atë që na thotë shkrimtari gjithashtu i cituar Ludvig, të cilin Divergu e përmendte gjithmonë si “Emil Ludvig Kohni”, se: “Çifuti Frankfurter, jo vetëm që ka qenë një ngordhalaq, jo vetëm që ushqehet nga xhepi i të atit rabin, por ka qenë edhe një

student harrakat, një parazit që i pëlqente të pispillosej dhe një duhanxhi i thekur.”

Pastaj nisi, në atë datë tri herë të mallkuar, viti i marrjes së pushtetit prej nazistëve, - aq shumë i kremtuar tash së fundi në internet. Duhanaxhi i thekur David përjetoi në Frankfurt am Main diçka që e tronditi atë dhe studentët e tjerë. Ai pa të digjeshin librat e autorëve hebrenj. Befas vendi i tij i studimit në laborator u stolis me një yll të Davidit. Urrejtja tashmë po e godiste nga fare afër, pothuajse fizikisht. Mbi të si dhe mbi të tjerë u derdhën fyerjet e studentëve që tashmë shpallnin haptas përkatësinë e tyre në racën ariane. Kjo ishte ca si tepër. Ai nuk duroi dot më. Iku në Bernë të Zvicrës për të vazhduar studimet në vendin më të sigurt, siç mendohej. Për tu rrëzuar sërish në mjaft nga provimet. Megjithatë vazhdoi t’i mashtronte prindërit që e mbanin me bukë, duke u shkruar letra optimiste, gati pozitive. Por një vit më vonë, pasi i vdiq e ëma, ai i ndërpreu studimet. Mbase duke dashur të gjente mbështetje tek të afërmit, kuturisi të shkonte edhe një herë në Rajh, ku në Berlin u bë dëshmitar i heshtur i skenës kur xhaxhain e tij, rabin edhe ai si i ati, një djalë i ri e tërhoqi zvarrë duke e kapur pas mjekrës së kuqërremtë, duke bërtitur “Çifut, hep-hep\*”.

Afërsisht kështu përshkruhet ngjarja edhe në librin e shkrimtarit të suksesshëm Emil Ludvig “Vrasje në Davos”, të botuar në vitin 1936 nga shtëpia botuese Querido e themeluar në Amsterdam nga emigrantët gjermanë. Përsëri vëllazëria e Shverinit në faqen e saj të internetit e rrëfente ndryshe këtë histori, duke iu referuar edhe një herë kolegut të partisë Diverg, i cili në shkrimin e tij citon si dëshmitar rabinin dr. Salomon Frankfurterin që, i marrë në pyetje nga



policia e Berlinit, paskësh thënë: “Nuk është e vërtetë që një adoleshent të më ketë tërhequr zvarrë nga mjekra (që, posa erdhi fjala, ishte e zezë dhe jo e kuqërremtë) duke bërë titur ‘Çifut, hep-hep!’”

Unë e pata të pamundur që të sqaroja nëse ky hetim i policisë i urdhëruar dy vjet pas incidentit të mëtuar, ishte zhvilluar apo jo nën shtrëngim. Sidoqoftë fakt është se David Frankfurter i u kthye përsëri në Bernë, dhe për shumë arsye duhej të ndjehej i dëshpëruar. Nga njëra anë i duhej të rifillonte studimet deri atëherë gjithsesi të pasuksesshme, nga ana tjetër tashmë dhimbjeve të tij kronike fizike erdhi dhe iu shtua edhe hidhërimi për vdekjen e së ëmës. Për më tepër, kujtimi i asaj vizite të shkurtër në Berlin bëhej edhe më i padurueshëm sa herë që lexonte në shtypin e vendit apo të huaj njoftime për kampet e përqendrimit në Oranienburg, Dakau apo gjetkë.

Kështu aty nga tridhjetë e pesa atij duhet t’i ketë lindur mendimi i vetëvrasjes, mendim që pastaj i përtëritej vazhdimisht. Më vonë, ndërsa po zhvillohej procesi, në një ekspertizë të porositur nga mbrojtja thuhet: “Për arsye të brendshme psikologjike të natyrës personale Frankfurteri kishte rënë në një gjendje emotive të paqëndrueshme, prej së cilës i duhej të çlirohej. Depresioni i tij pillte mendime vetëvrasjeje. Por instinkti i vetëruajtjes gjithmonë i pranishëm në çdo qenie njerëzore ia ndryshoi plumbit drejtimin nga vetvetja tek një viktimë tjetër”.

Për këtë temë në internet nuk kishte komente të hollësishme. E megjithatë në mendjen time përherë e më tepër po përvidhej mendimi se nën atë adresë maskuese *www.blutzeuge.de* ajo që fshihej pas vëllazërisë së Shverinit

nuk qe ndonjë tufë kokëtullacësh, por një individ i vetëm dinak. Dikush, që sikundër unë, kërkonte me nuhatje nëpër internet gjurmët dhe sekrecione të tjera të historisë.

Ndonjë student i çoroditur? Siç kam qenë dhe unë vetë atë kohë kur gjermanistika filloi të më dukej e shpifur dhe studimet në shkencën e komunikimit në Institutin Oto-Sur, ca si tepër teorike.

Fillimisht, kur u largova nga Shverini, dhe pastaj kalova me tramvaj nga Berlini Lindor në atë Perëndimor, iu futa studimit, siç i kisha premtuar edhe nënës kur qemë ndarë, dhe madje rëndshëm, si ndonjë karrierist. I kisha nja gjashtëmbëdhjetë vjet e gjysmë, fill para ndërtimit të Murit, kur për herë të parë fillova të marr erën e lirisë. Banoja në Shmargartendorf, pranë Rozenekut, në shtëpinë e Jenit, një shoqe shkolle e nënës, me të cilën në të ri ajo pretendonte se kishte bërë plot marrëzira. Kisha një dhomë më vete, me dritare-baxho në çati. Qe me të vërtetë një kohë e bukur.

Apartamenti në mansardë i teto Jenit në Karlsbader Shtrase, dukej si ndonjë shtëpi kukulle. Figurina porcelani kudo, mbi tryezat e vogla, nëpër mbajtëse, nën kapakë qelqi. Kryesisht valltare me geta dhe papuçe balerinash duke qëndruar në majtë të gishtave. Disa në pozicione të kuturisura, të gjithë me kokë të vogël dhe qafë të gjatë. Në çupëri teto Jeni kishte qenë balerinë, madje mjaft e përmendur, deri sa gjatë njërit prej bombardimeve të shumta, që sa vinte dhe po e rrafshonin kryeqytetin e Rahjut, asaj iu gjymtuan të dyja këmbët, ndaj dhe tani çalonte kur më sillte mua lloj-lloj gjërash për të shoqëruar çajin, ndonëse nga ana tjetër me ca lëvizje gjithnjë të hijshme të duarve. Dhe ashtu si figurinat

e brishta të mansardës së saj krejt të pastër, në kokën e saj të vogël dhe të lëvizshme mbi qafën tashmë krejt të hollë, ravijëzohej një buzagaz që dukej si i akulluar. Edhe ajo vetë rrëqetëj vazhdimisht nga të ftohët dhe pinte pa reshtur çaj të nxehtë.

Më pëlqente të banoja tek ajo. Ajo më mbante në pëllëmbë të dorës. Dhe kur fliste për shoqen e shkollës “Tula ime e dashur, ka gjetur mënyrën të më dërgojë përsëri një pusullë të vogël...”, unë përpiqesha për një çast ta shihja pak më me dashuri nënën time, atë paçavure të rreptë, të mallkuar; por pastaj sakaq më hipnin xhindet sërish. Mesazhet e saj të ardhura kontrabandë nga Shverini në Karlsbader Shtrase, qenë të mbushura plot me qortime të nënvizuara dhe kategorike, që, sipas shprehjes së nënës, “duhej të më shponin mua”: “Djali duhet të mësojë, të mësojë. Prandaj dhe vetëm prandaj e kam dërguar djalin në Perëndim, të bëhet dikushi...”.

Dhe në veshin tim fjalët e saj përktheheshin kështu: “Unë rroj vetëm e vetëm që një ditë djali im të ma dëshmojë këtë...” Dhe kur edhe teto Jeni, zëdhënësja e shoqes së saj, më këshillonte me zërin e saj të butë dhe gjithmonë të mprehtë, mua nuk më mbetej tjetër veçse të mësoja pa e ngritur kokën.

Shkoja asokohe në një gjimnaz së bashku me një hordhi bashkëmoshatarësh ‘të arratisur nga Republika’. Më duhej të mësoja një qerre rregullash në fushën e shtetit ligjor dhe të demokracisë. Anglishtes iu shtua edhe frëngjishtja, por ama nuk kisha më rusisht. Ndërkaq fillova të kuptoj edhe se si kapitalizmi funksionon edhe falë administrimit të menduar mirë të papunësisë. Nuk isha vërtet ndonjë

nxënës i shkëlqyer, por dëftesën ama, siç ma kishte kërkuar nëna, arrita ta marr.

Por edhe në gjërat e tjera, edhe me ato që kishin të bënin me vajzat, nuk ia kaloja keq dhe xhepin e kisha të ngrohtë, sepse nëna, pasi me bekimin e saj unë kisha kaluar tek armiku i klasës, më kishte dërguar edhe një adresë tjetër në Perëndim: “Ky osht yt atë, ma merr mendja. Një kushri imi. Ai më mbushi, fill para se të vinte kapelen e ushtarit. Së paku ai kështu beson. Kur te jesh atje matanë çoji haber si ia kalon... ”.

Nuk është se krahasimi qëndron, por për sa i përket gjendjes ekonomike edhe mua po me ndodhte si David Frankfurterit në Bernë, të cilit babai i derdhte muaj për muaj një dorë të mirë parash në llogarinë e tij zvicerane. Kushëriri i nënës, që i ndrittë shpirti, quhej Harri Libeman, ishte i biri i një marangozi në ish-rrugën Elzenshtrase, që prej fundviteve pesëdhjetë jetonte në Baden-Baden dhe në detyrën e tij si redaktor i kulturës në Radion Jugperëndimore, mbante programin e natës: “Poezi lirike në mesnatë”, edhe pse si dëgjues kishte mbase vetëm pishat e Shvarcvaldit.

Meqenëse nuk doja t’i rëndohesha edhe më shumë shoqes së shkollës së mamit, qëndisa një letër të lezetshme dhe fill pas formulës përmbyllëse “Djali yt i panjohur” i bëra të ditur me një shkrim krejt të lexueshëm numrin tim të llogarisë. Duke qenë, me sa duket, i lidhur në një martesë të lumtur, ai nuk më ktheu përgjigje me shkrim, por gjithsesi filloi të më derdhë saktësisht çdo muaj në llogari shumë më tepër nga ç’ ishte pensioni ushqimor minimal, ose rrumbullak dyqind marka, që ishin goxha para asokohe. Për këtë punë teto Jeni

nuk kishte dijëni, edhe pse ajo, me siguri, duhej ta kishte njohur, qoftë mbase vetëm kalimthi, Harrin, kushëririn e nënës, gjë që, me atë prushërim të lehtë të fytyrës së saj prej kukulle, ajo më tepër ma pohoi se sa ma tha.

Aty nga fillimi i gjashtëdhjetë e shtatës, pasi i kisha lënë lamtumirën Karsbader Shtrases dhe isha shpërngulur në Krojçberg, sepse i kisha vënë vizë studimeve dhe kisha zënë punë si reporter i jashtëm në “Morgenpost” të Shpringerit, pushoi edhe ai currili i bekuar i parave. Prej asaj kohë nuk i shkrova më babait tim financiar, hiq mbase ndonjë kartolinë për Krishtlindje, asgjë më tepër. Se fundja përse? Ashtu, nëpërmjet të tjerëve, nëna ma kishte çuar lllafin: “Edhe shumë temena nuk ke pse t’i bësh, ai e di mirë se përse duhet të paguajë...”.

Më hapur Ajo nuk më shkruante dot asokohe, se ndërkaq punonte si brigadiere në një zhdukthtari të madhe shtetërore, që prodhonte sipas planit dhoma gjumi. Si anëtare partie ajo nuk duhej të kishte kontakte me Perëndimin, aq më pak me të birin, një i arratisur nga Republika, i cili shkruante artikuj fillimisht të shkurtër, më vonë më të gjatë, në shtypin e propagandës kapitaliste kundër sistemit komunist që s’mbahej dot pa muret dhe telat me gjemba, gjë që i kishte shkaktuar asaj jo pak telashe.

Ma ha mendja se kushëriri i nënës nuk deshi të paguante më me të marrë vesh që në vend të studioja, unë po punoja për gazetën e shpifur të Shpringerit. Gjithsesi, në një farë mënyre me atë botëkuptimin e tij të dhjerë liberal, s’është se s’kishte të drejtë. Ndonëse nuk zgjati shumë dhe, fill pas atentatit ndaj Rudi Dutshkes\*, unë u largova edhe nga Shpringeri. Dhe që atëherë kam qenë i pozicionuar hapur

majtas. Dhe, me që asokohe bota ziente, shkrova për një tufë gazetash pak a shumë përparimtare dhe u mbajta bukurisht në sipërfaqe, edhe pse s'fitoja më shumë se sa tri herë se pensioni ushqimor minimal. Aq më tepër që ky zotëria Libenau nuk paskësh qenë aspak babai im. Ishte sajim i nënës. Prej saj unë mora vesh më vonë se redaktori i programeve të natës kishte vdekur prej zemrës aty nga fundi i viteve shtatëdhjetë, që përpara se të martohesha unë. Ishte në moshën e nënës, afërsisht pak mbi të pesëdhjetat.

Po prej saj mu bënë të njohur, në rolin e zëvendësuesve, emrat e disa burrave të tjerë që mund të merreshin parasysh si baballarë. Njërin, të humbur pa gjurmë, që me ç' dukej e kishin quajtur Joahim apo John, një tjetër, një burrë më i moshuar që thonë se paskësh helmuar qenin pastor Harras, duhet ta ketë pasur emrin Valter.

Shkurt unë nuk kam pasur asnjëherë një baba të vërtetë, por vetëm fantazma zëvendësuese. Ndaj dhe këta tre heronjtë që ajo më ofronte, për mendimin tim, do bëja mirë t'i harroja. Po gjithsesi, është e qartë se as nëna vetë atë paradite të 30 janarit të dyzet e pesës, kur, së bashku me prindërit, i kishte hipur anijes në kalatën e Gotenhafen-Okhëftit, bashkë me shtatëmijë e kusur persona të tjerë, në të vërtetë nuk e kishte ditur se kush e kishte mbarsur. Ai, emrin e të cilit mbante anija, mund të dëshmonte si baba të vetin një tregtar, një farë Herman Gustlof. Kurse ai, i cili ia doli ta fundosë anijen e mbingarkuar, në të ri kishte ngrënë shpesh dajak nga i ati, Marinesko, nga që bënte pjesë në një bandë vjedhësish që, me ç' thuhet, quhej "Blatnije", gjë që gjithsesi duhet parë si një si dëshmi e kujdesit atëror. Edhe David Franikurteri, që mori udhën nga Berna për në Davos,

duke bërë kësisoj që anija të merrte emrin e një martiri, kish pasur për baba një rabin të mirëfilltë. Por edhe unë, i pa baba, u bëra më së fundi baba, si gjithë të tjerët.

Çfarë duhani thua të ketë pirë ai? Juno, ato cigaret krejt të rrumbullakëta? Apo nga ato orientalet e holla? Apo, mbase, për të ndjekur modën, ato që pihen me cigarishte floriri? Si duhanpirës prej tij nuk ka veçse një fotografi të vonë gazete, aty nga fundi i viteve gjashtëdhjetë, që e paraqet atë gjatë një qëndrimi të shkurtër në Zvicër, me cigaren e ndezur në gojë si një zotëri të moshuar që së shpejti do t'i lëre lamtumirën karrierës së zyrtarit. Sidoqoftë, sikundër edhe unë, ai qe një duhanxhi i thekur, ndaj edhe kur udhëtonte me Hekurudhat federale zvicerane, zinte vend gjithmonë në vagonin ku lejohej duhani.

Që të dy udhëtonin me tren. Në kohën që David Frankurteri udhëtonte nga Berna në Davos, Vilhelm Gustlofi qe në një turne organizativ. Gjatë këtij udhëtimi ai vizitoi shumë prej grupeve vendore të Partisë Nacional-socialiste jashtë vendit, duke themeluar shumë celula mbështetëse të Rinisë hitleriane dhe të BdM\*, Lidhjes së Vajzave gjermane. Duke qenë se ky udhëtim i tij u bë aty nga fundi i janarit, ai s'ka dyshim që do ketë mbajtur fjalime të zjarrta para gjermanëve të Rajhut dhe austriakëve që banonin në Bernë dhe në Zyrih, në Glarus dhe në Cug, me rastin e përvjetorit të tretë të marrjes së pushtetit. Me qenë se punëdhënësi i tij, Observatori, e kishte pushuar nga puna një vit më parë, me kërkesën këmbëngulëse të deputetëve socialdemokratë, tani ai ishte i lirë ta përdorte kohën si të donte. Ç'është e vërteta, ndonëse për shkak të veprimtarisë së tij agjitative

brenda territorit të Zvicrës kishte gjithnjë protesta, gazetat e majta e quanin “diktatori i Davosit”, dhe këshilltari federal Bringolf madje kishte kërkuar dëbimin e tij, në kantonin e Graubundenit, madje në krejt Zvicrën ai gjente plot politikanë dhe zyrtarë që e mbështesnin jo vetëm financiarisht. Në Davos administrata e hotelerisë kujdesej që t’i jepte rregullisht listën e pushueseve të sapo ardhur, në mënyrë që ai të kishte mundësi të kontaktonte gjermanët e Rajhut që gjendeshin aty, jo vetëm duke i ftuar por duke iu kërkuar të vinin në veprimtaritë e partisë; mungesat pa arsye mbaheshin shënim dhe emrat e tyre i raportoheshin organeve përkatëse të Rajhut.

Pak a shumë në kohën kur studenti duhanpirës i hipi trenit në Bernë pasi kishte blerë një biletë të thjeshtë dhe jo vajtje-ardhje, dhe gjatë kohës që martiri ynë i ardhshëm jepte prova të përkushtimit të tij ndaj partisë, nënoficeri Aleksandër Marinesko kaloi nga marina tregtare në flotën e kuqe ushtarake detare të Detit të Zi, në shkollën e së cilës kreu një kurs navigimi dhe pastaj mori patentën e drejtimit të nëndetëses. Njëherësh bëhet edhe anëtar i organizatës së rinisë, Komsomolit, dhe fiton emër si alkoolpirës i thekur, - në shërbim ama ishte shembullor dhe nuk ndodhte kurrë që ta merrte shishen me vete në anije. Nuk vonoi dhe Marineskon e caktuan oficer navigimi të nëndetëses Sch 306 Pische; kjo njësi që sapo i ishte dhënë në përdorim flotës, me të filluar lufta, ndërkohë që Marinesko ishte ende oficer navigimi në një nëndetëse tjetër, ndeshi në një minë dhe u mbyt me të gjithë ekuipazhin në bord.

Nga Berna në Zyrh dhe pastaj nëpër një sërë liqenesh. Në shkrimin e tij, që përshkruan rrugën e studentit të mjekësisë,



Divergu, shoku i partisë, nuk merret me përshkrimin e peizazhit. Por edhe vetë duhanpirësi i thekur tashmë në vitin e shtatë të studimeve, ka të ngjarë të mos i ketë kushtuar shumë vëmendje vargmaleve që i dalin përpara dhe së fundi ia mbyllin fare horizontin; më së shumti ai do ketë shumti ai do ketë venë re dëborën që mbulonte shtëpi, pemë dhe male, po ashtu edhe ndërrimin e dritës sa herë që treni kalonte nëpër tunele.

David Frankfurter i nis për rrugë në 31 janar të vitit 1936. Ai po lexonte gazetën dhe pinte duhan. Në rubrikën "Të ndryshme" mund të lexoje një sërë njoftimesh për veprimtaritë e landesgruppenlajterit Gustlof. Të përditshmet, ndër to edhe "*Neue Zürcher*" dhe "*Basler Nationalzeitung*", tregonin me datë gjithçka që po ndodhte apo për veprimtaritë që priteshin të zhvilloheshin në të ardhmen. Në fillim të atij viti, që do të hynte në histori si vit i Olimpiadës së Berlinit, Italia fashiste nuk e kishte pushtuar ende Abisininë, perandorinë e largët të Negusit, ndërsa në Spanjë po dukeshin shenjat e para të luftës. Në Rajhun gjerman ndërtimi i *Autobahn*-eve po bënte përparime, ndërkohë që në Langfur nëna kish mbushur tetë vjeç e gjysmë. Dy beharë më parë ishte mbytur duke u larë në Ostze, Konradi, vëllai i saj shurdhmemec dhe kokëkaçurrel. Kishte qenë vëllai i saj i preferuar. Andaj edhe tani, dyzet e gjashtë vjet pas vdekjes së tij, mua mu desh t'ia vija djalit tim emrin Konrad; por nga të gjithë thirrej "Koni", ndërsa në letrat e Rozit, mikeshës së tij, shkruhej "Conny".

Tek Divergu thuhet se Landesgruppenlajteri u kthye në datën 3 shkurt, i lodhur nga udhëtimi i suksesshëm nëpër kantone. Frankfurter i dinte se në datën tre ai do të vinte në

Davos. Përveç shtypit të përditshëm, ai lexonte rregullisht edhe gazetën e partisë Der Reichsdeutsche “(Gjermani i rajhut)”, që nxirrte Gustlofi, ku shënoheshin paraprakisht e me saktësi datat e gjithë veprimtarive të tij. Davidi njihte gati gjithçka që lidhej me objektivin. Kishte thithur, si të thuash, gjithë ç’mund të mbante brenda vetes. Por a e dinte ai edhe që me kursimet e mbledhura çifti Gustlof kishte ndërtuar një shtëpi të bukur me tulla në Shverin dhe e kishte mobiluar për merak, me mendje që një ditë të ktheheshin në Rajh? Dhe se të dy bashkëshortët dëshironin me zjarr një djalë?

Kur studenti i mjekësisë erdhi në Davos sapo kishte rënë dëborë e parë. Dielli shkëlqente mbi dëborë dhe qendra klimaterike ngjasonte me një kartolinë. Ai kishte ardhur pa bagazh, por me një synim të qartë. Nga “Basler Nationalzeitung” ai kishte prerë një fotografi të Gustlofit me uniformë: një burrë shtatlartë, me një vështrim të vendosur dhe të përqendruar dhe me një ballë të zmadhuar nga rënia e flokëve.

Frankfurtereri zuri vend në lagjen e Lowe-it. Do t’i duhej të priste deri të martën, 4 shkurt. Kjo datë e javës tek çifutët quhej “kitov” dhe mbahet si ditë me shans; informacion ky që e peshkova në internet. Në *web* faqen tashmë aq të njohur për mua, kjo datë i kushtohej përkujtimit të martirit.

Duke pirë duhan nën rrezet e diellit, mbi dëborën e fortë. Çdo hap kërciste. Të hënën e kaloi me vizita në qytet. Tutje tehu nëpër bulevardin e qendrës. Ndejti të shihte një ndeshje hokeji, si një shikues i zakonshëm midis shikuesve të tjerë. Ndonjë bisedë e rastësishme me pushuesit e tjerë.

Fryma i formonte re të bardha. Duke u përpjekur të mos zgjonte asnjë dyshim. Pa asnjë fjalë të tepërt. Pa asnjë nxitim. Gjithçka ishte gati. Me një revolver të blerë në dorë ishte stërvitur në një poligon qitjeje në afërsi të Bernës - gjithçka krejt e ligjshme. Sado shëndetlig, dora e tij u tregua e qetë.

Të martën, kur mbërriti në afërsi të vendit, i erdhi në ndihmë një tabelë ku shkruhej: "Wilhem Gustlof - PNSGJ": nga shëtitörja e madhe degëzohej rruga "Am Kurpark", që të çonte në shtëpinë numër 3. Një ndërtesë me çati të sheshtë, e suvatuar e lyer në një blu të shpëlarë, nga ulluqet e së cilës vareshin heje akulli. Vetëm disa pak fenerë rruge luftonin me errësirën e mbrëmjes. Dëborë s'po binte më.

Kaq për skenën e jashtme. Hollësitë e tjera nuk kanë ndonjë rëndësi. Për ecurinë e atentatit të vetmit që do të mund të flasin më vonë janë atentatori dhe vejusha. Unë pata mundësi ta shihja brendësinë e asaj pjese të banesës nëpërmjet një fotografie që shoqëronte tekstin e hedhur për këtë qëllim në *web* faqen e përmendur. Me sa dukej fotografia duhej të ishte bërë pas krimit, sepse tre tufa me lule të freskëta në tryezat e vogla dhe, si edhe një vazo me lule të çelura në një komodinë, i jepnin dhomës një pamje përkujtimore.

Pasi ra zilja, derën e hapi Hedvigë Gustlofi. Një djalosh, për të cilin ajo do të dëshmonte më vonë se kishte pasur sy të pëlqyeshëm, kërkoi të fliste me Landesgruppenlajterin. Atë çast ai qe në korridor e po bisedonte në telefon me kolegun e partisë dr. Habermanin, nga organizata e Tunit. Frankfurteri pretendonte se kur i kaloi pranë i kishte kapur veshi shprehjen "derr çifut", çka zonja Gustlof e kundërshtoi më vonë, duke thënë se një fjalor i tillë kishte qenë i huaj për

bashkëshortin e saj, edhe pse zgjidhjen e çështjes së çifutëve ai e konsideronte si tepër të ngutshme.

Ajo e futi vizitorin në dhomën e punës së të shoqit dhe iu lut të ulej. Asnjë dyshim. Shpesh vinin pa lajmëruar nevojtarë, ndër ta edhe kolegë partie që kishin rënë në hall.

Nga kolltuku ku ishte ulur, me mantelin dhe kapelën mbi gjunjë, studenti i mjekësisë shihte tryezën e shkrimit, sahatin e murit brenda kutisë së drunjtë, pakëz të fryrë, përmbi të varur Thikën e nderit të SS. Përsipër si dhe anash Thikës së nderit, fotografi të shumta bardhezi dhe me ngjyra të Fyrerit dhe të kancelarit të Rajhut, përbënin të vetmet zbukurime në atë dhomë. Por as edhe një fotografi të Gregor Shtraserit, mentorit të vvarë para dy vjetësh. Në të majtë, modeli i një anijeje, me siguri *Gorch Foch*.

Më tej vizitori në pritje, që po duronte pa pirë duhan, pati mundësi të shihte në një komodinë pranë tryezës së shkrimit, një radioaparatur, pastaj bustin e Fyrerit, derdhur në bronz, ose në allçi por i lyer që të dukej si prej bronzi. Lulet e prera të fotografuara mbi tryezë duhej të kenë qenë aty para vrasjes në ndonjë vazo, të vendosura plot dashuri nga zonja Gustlof për të përshëndetur burrin pas ndonjë udhëtimit të lodhshëm, apo edhe si urim për ditëlindje.

Mbi tryezën e shkrimit çikërrima dhe një mori letrash të hedhura pa kujdes: raporte, mbase të organizatave kantonale, e me siguri korrespondenca me organet zyrtare të Rajhut, ndoshta dhe ndonjë letër kërcënuese që kohëve te fundit posta ia kishte sjellë me bollëk. Por Gustlofi nuk e kishte pranuar mbrojtjen policore.

Ai hyri në dhomë vetëm, pa të shoqen. Shtatdrejtë

dhe i shëndetshëm, me që prej vitesh ia kishte hedhur tuberkulozit, i veshur civil, ai shkoi drejt vizitorit, i cili as u ngrit nga kolltuku, por e qëlloi ashtu siç ishte, ndenjor, me të nxjerrë revolverin nga xhepi i mantelit të madh. Duke goditur drejt e në shenjë, plumbat bënë katër vrima në gjoksin, qafën dhe kokën e landesgrupearit. Ai u gremis përdhe pa nxjerrë asnjë zë, mu përpara fotografive me kornizë të Fyrerit të tij. Sakaq në dhomë u fut e shoqja, e cila pa së pari revolverin ende të drejtuar nga viktimja, pastaj të shoqin e rrëzuar përdhe, të cilit, ndërkohë që ajo u përkul përmbi të, nisi t'i shpërthente gjaku nga të gjitha vrimat e plagëve.

David Frankfurteri, udhëtari pa biletë kthimi, vuri kapelën në kokë dhe u largua nga vendi i veprës së tij të paramenduar, i papenguar nga banorët e tjerë të shastisur të godinës, brodhi disa çaste tutje-tëhu nëpër dëborë, u rrëzua dhe u ngrit sërish disa herë, dhe me numrin e urgjencës në kokë, kallëzoi veten si autorin e asaj që kishte ndodhur në një kabinë telefonike, më së fundi gjeti edhe postën më të afërt ku iu dorëzua policisë kantonale.

Fjalinë e mëposhtme e shqiptoi para dezhurnit të policisë që mbajti protokollin dhe pastaj e përsëriti të pandryshuar edhe para gjyqit: “Qëllova sepse jam hebre. Jam plotësisht i ndërgjegjshëm për veprimin tim dhe nuk jam penduar aspak”

Pas kësaj vijon një mal i tërë shkrimesh. Ajo që tek Wolfgang Divergu u cilësua si “një vrasje e poshtër”, tek romancieri Emil Ludvig u himnizua si “Lufta e Davidit kundër Goliatit”. Këto vlerësime krejt të përkundërta vazhdojnë edhe deri sot në përditësinë tonë virtuale. Pa

kaluar shumë kohë, gjithçka që ndodhi më pas, përfshi këtu edhe vetë procesin gjyqësor, shkoi përtej autorit të vrasjes ashtu dhe vetë viktimës, duke marrë përmasa mitike. Heroit të gjedhes biblike që me aktin e tij donte t'i bënte thirrje për qëndresë popullit të tij të shumëvujtur, iu vu përballë martiri i lëvizjes nacional-socialiste. Të dy kërkonin të hynin në librat e historisë në madhësi mbinatyrore. Por vrasësi sidoqoftë, u harrua shpejt; edhe nëna, asokohe kur ishte fëmijë dhe quhej Tula, nuk kishte dëgjuar kurrë për ndonjë vrasje apo vrasës, por vetëm llafe të përrallshme për një anije që të merrte sytë më bardhësinë e saj dhe të ngarkuar me njerëz gazmorë, që bënte udhëtime të shkurtra detare për një shoqatë që e quante veten "*Kraft durch Freude*" (Fuqi nëpërmjet gëzimit).